



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**MBI KATEGORITË E INVESTIMEVE TË LEJUARA, KUFIZIMET QË ZBATOHEN DHE
PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE FINANCIARE DERIVATIVE**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 76, datë 30.05.2016

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton:

- a) Kategoritë e investimeve të lejuara;
- b) Kufizimet që zbatohen për investimin e aktiveve;
- c) Përdorimin e instrumenteve financiare derivative;
- d) Përmbajtjen, mënyrën dhe afatet kohore për njoftimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 78, pikat 5 dhe 6 dhe nenit 99 pika 3 , të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha shoqëritë e sigurimit, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 4
Lloji i investimeve të lejuara**

Do të konsiderohen investime të lejuara kategoritë e listuara si më poshtë vijon:

- a) Toka dhe ndërtesa;

- b) Investime në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse, të cilat konsistojnë në:
 - 1. Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në filiale;
 - 2. Letra borxhi të emetuara nga, dhe hua dhënë filialeve;
 - 3. Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në shoqëri me interesa pjesëmarrëse;
 - 4. Letra borxhi emetuar nga, dhe hua dhënë shoqërive me interesa pjesëmarrëse;
 - 5. Investime të tjera në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse.
- c) Investime financiare, të cilat konsistojnë në:
 - 1. Të mbajtura deri në maturim si:
 - 1.1 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse që janë:
 - 1.1.1 Letra me vlerë të Qeverisë;
 - 1.1.2 Të tjera.
 - 2. Të vlefshme për shitje, të cilat janë:
 - 2.1 Aksione, letra borxhi me të ardhura të ndryshueshme, fonde investimesh dhe pjesëmarrje në fonde të tjera të cilat ndahen në:
 - 2.1.1 Të listuara;
 - 2.1.2 Të palistuara.
 - 2.2 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse si:
 - 2.2.1 Letra borxhi të Qeverisë;
 - 2.2.2 Të tjera.
 - 3. Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, të cilat ndahen në:
 - 3.1 Aksione, letra borxhi me të ardhura të ndryshueshme, fonde investimesh dhe pjesëmarrje në të tjera fonde;
 - 3.2 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse;
 - 3.3 Derivative;
 - 3.4 Të tjera.
 - 4. Depozita në bankë.
 - 5. Hua hipotekore.
 - 6. Hua të tjera.
 - 7. Investime të tjera financiare.

Neni 5

Llojet e instrumentave të investimit

- 1. Shoqëria e sigurimit lejohet të investojë në aktivet e përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje nëpërmjet instrumentave të listuara në nenin 97, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
- 2. Shoqëria e sigurimit lejohet të investojë në aktivet e listuara më sipër nëpërmjet instrumentave të listuara në nenin 4, të Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve”.
- 3. Investime në lloje të tjera asetesh me miratim paraprak të Autoritetit.
- 4. Në raste të veçanta dhe me kërkesë të shoqërisë së sigurimit, Autoriteti të miratojë investimet në Instrumenta financiare derivative, me kusht që të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kufizimet e Investimeve

Shoqëria e Sigurimit mund të investojë lirisht në instrumentat e lejuara sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje në rastet kur janë përmbushur të gjitha këto kushte:

- a) Shoqëria ka mbuluar provigjonet teknike dhe/ose provigjonet matematike sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- b) Shoqëria zotëron treguesin e aftësisë paguese sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- c) Shoqëria nuk cënon nivelin e likuiditetit;
- d) Ndaj shoqërisë nuk është marrë masë apo kufizim nga ana e Autoritetit lidhur me investimet e saj.

Neni 7

Përdorimi i instrumentave financiare derivative

1. Instrumente financiare derivative janë ato instrumenta të përcaktuara në nenet 7-11 të Ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt”.
2. Shoqëria e sigurimit mund të përdorë instrumente financiare derivative vetëm në investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe nëse ato zvogëlojnë rrezikun e përcaktuar në nenin 99, pika 1, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ose nëse ato mundësojnë administrimin më efikas të portofolit.
3. Investimet në instrumente financiare derivative që lejohen të përdoren janë vetëm ato të tregtuara në tregje financiare të rregulluara investimi në to lejohet vetëm me miratim paraprak nga ana e Autoritetit në kushtet e mëposhtme:
 - a) Aktiv i mbi të cilin është nënshkruar instrumenti financiar konsiston në kontrata të “*futures*”, opsione mbi indekset financiare, opsione mbi normat e interesit dhe opsione mbi valutë, në të cilat kompania e sigurimit ose risigurimit mund të investojë në përputhje me nenin 99 të Ligjit nr. 52/2014 dhe të rregullores aktuale.
 - b) Përpara se të investojë në instrumenta financiare derivative shoqëria e sigurimit/risigurimit duhet të depozitojë një dokument të brendshëm për investimin në Instrumentat Financiare Derivative dhe ta dorëzojë atë në Autoritet. Dokumenti i brendshëm përmban informacion të plotë, të saktë dhe objektiv për mënyrën e matjes dhe menaxhimit të risqeve që rrjedhin nga aktiv i në mbulim të provigjoneve teknike. Të drejtat nga instrumentet financiare derivative, të cilat janë të investuara për të vetmin qëllim të mbrojtës reciproke aktivet individuale ose disa ndaj ndryshimeve në vlerë, lidhja e instrumentit financiar mbrojtës me aktivin duhet të jenë të qarta. Efektiviteti i marrëdhënies mbrojtëse duhet të dokumentohet edhe në dokumentin e brendshëm për investim dhe të rishikohet në

baza të rregullta shoqëria e sigurimit raporton në Autoritet për përdorimin e instrumenteve financiare derivative.

- c) Departamenti përkatës i menaxhimit të riskut në shoqëri është përgjegjës të përcaktojë në çdo moment që shoqëria është në gjendje të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata me instrumentat financiare derivative.

Neni 8

Mënyra dhe afatet e njoftimit

1. Shoqëria e sigurimit do të njoftojë Autoritetin për investime në lloje të tjera asetesh, 1 javë përpara se të kryej investimin.
2. Shoqëria e sigurimit duhet të depozitojë në Autoritet politikat e investimit në çdo raportim financiar fundviti.

Neni 9

Masat mbikëqyrëse

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në Ligjin nr. 52/2014 “Për sigurimet dhe risigurimet”, si dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.